



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr 02-170/06-56102 dt. 27/10/2022

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, bazuar në nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ,27. 10.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Prof. Dr. Alfred Moisiu, "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

Neni 1

Më këtë Vendim të Kuvendit të Komunës miratohet shpallja e Prof. Dr. Alfred Moisiu "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli "Qytetar Nderi" Prof. Dr. Alfred Moisiu i jepet për kontributin e tij në politikën e mbrojtjes, të sigurisë rajonale si dhe për zhvillimet në Kosovë.

Neni 3

Titulli Qytetar Nderi sipas këtij Vendimi do të ndahet nga kryetari i Komunës, i cili autorizohet të përcaktoj formën e dekoratës, mënyrën e dhënies si dhe çështjet tjera sa i përket organizimit të ndarjes së titullit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatesë;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;
Palës;



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

ARSYETIM

Prof. Dr. Alfred Moisiu lindi më 1 dhjetor 1929, në qytetin e Shkodrës. Alfred Moisiu ka marrë pjesë në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Në vitet 1946-1948 kreu studimet në Shkollën e Inxhinierisë Ushtarake në Petersburg, Rusi, dhe u laureua në Akademinë e Inxhinierisë Ushtarake në Moskë me Medalje të Artë në vitet 1952-1958. Në vitet 1948-1949 ka qenë Komandant toge në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë; Instruktor në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” në vitet 1949-1951; ka punuar në Drejtorinë e Xhenios të Ministrisë së Mbrojtjes në vitet 1958-1966.

Kursin e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e kreu në vitet 1967-1968 në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë.

Zoti Moisiu shërbeu si zëvendësministër i Mbrojtjes, nga viti 1981 deri në tetor 1982. Në vitet 1982-1984 ka qenë Komandant i Kompanisë së Xhenjos në Burrel dhe në vitin 1985 doli në pension.

Në vitin 1991 zoti Moisiu u emërua Ministër i Mbrojtjes së Qeverisë Teknike, post të cilin e mbajti deri në vitin 1992. Në vitet 1992-1994 ai punoi si Këshilltar i Ministrit të Mbrojtjes; në vitet 1994-1997 ishte zëvendësministër për Politikën e Mbrojtjes.

Alfred Moisiu themeloi më 1994-ën Shoqatën Shqiptare të Atlantikut, ku u zgjodh President.

Në vitin 1995 kreu Kursin për Personalitete të Larta në Kolegjin Ushtarak të NATO-s, në Romë. Zoti Moisiu është autor i mjaft shkrimeve, artikujve dhe studimeve të botuara në shtypin shqiptar e të huaj, për problemet e artit ushtarak, të politikës së mbrojtjes, të sigurisë rajonale si dhe për zhvillimet në Kosovë. Alfred Moisiu mban titullin shkencor “Doktor i Shkencave Ushtarake”.

Prof. Dr. Alfred Moisiu më 24 qershor të vitit 2002 zgjidhet President i Republikës së Shqipërisë.

Ish-Presidenti Alfred Moisiu i mbetur i ve pas ndarjes nga jeta të bashkëshortes ka trashëguar katër fëmijë, tri vajza dhe një djalë, i cili humbi jetën në një aksident tragjik gjatë mandatit të tij si President.

Zoti Moisiu është njohës i tri gjuhëve, ruse, italiane dhe angleze.

Andaj, angazhimi i ish presidentit Moisiu për çështjen e Kosovës, në të gjitha nivelet, ato shkencore, politike dhe shoqërore, përgjatë dekadave, është për t’u vlerësuar me titullin “Qytetar nderi” i komunës së Drenasit.